UDHËZIM
Nr. 23, datë 16.10.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 15, DATË 19.5.2017, "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË VITIN AKADEMIK 2017-2018", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në pikën 2, germa "C" e kreut III, të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, shtohet si më poshtë:

"2. Gjatë periudhës 16 deri 26 tetor, institucionet e arsimit të lartë vijojnë me procedurat e regjistrimit të kandidatëve nëpërmjet portalit U-Albania, në programet e studimit në të cilat kanë aplikuar në raundin e parë apo të dytë. Të drejtën e regjistrimit e kanë kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi. Institucionet e arsimit të lartë gjatë regjistrimeve respektojnë renditjen e kandidatëve deri në plotësimin e kuotave. Procedurat për regjistrimin e kandidatëve përcaktohen nga njësitë kryesore të IAL-ve.".

2. Pika 4 e germës "C", të kreut III të udhëzimit nr. 15, datë 19.5.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

"4. Në rast se përfundon e gjithë lista e kandidatëve që kanë aplikuar në raundin e dytë dhe mbeten kuota të paplotësuara në programet përkatëse të studimit, njësitë bazë në institucionet e arsimit të lartë përzgjedhin kandidatët fitues sipas kërkesave të depozituara nga kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, pavarësisht përzgjedhjeve në raundin e parë apo të dytë. Kandidatët përzgjedhin dhe rankohen nga njësitë bazë dhe miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, duke njoftuar QSHA-në dhe duke ngarkuar një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania. Sekretaritë mësimore regjistrojnë kandidatët e miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore sipas renditjes deri në plotësimin e kuotave për programet përkatëse të studimit.

Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij, kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 16 deri më datë 26 tetor 2017, nëpërmjet dokumentacionit të përcaktuar në këtë udhëzim.".

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla